

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	631-21-2961-5-1-1
Nr i brendshëm	631 21 017 511

Sa i përket tenderit për

Ndërtimi i varrezave të qytetit në Deçan -faza 1

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

RSM COMPANY SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

ÇAGLLAVICE, RR.DARDANET NR 21, PRISHTINE

(Adresa)

PRISHTINE

(Vendi)

045977750

(Numri Telefonit)

10000

(Kodi postar)

N/A

(Numri i Faks-it)

AGIM KOLA

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

rsm.prishtina@gmail.com

(Adresa elektronike)

26.05.2021

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimim per kontrate eshte publikuar me dt.20.05.2021

Afati i fundit per dorezimin e tendereve eshte me dt. 09.06.2021, ora 14:00

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti kontraktues ka bërë shkeljen e dispozitave të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237:

Neni 7

Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi thote:

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik.
3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.
4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve

që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kriterëve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

PRETENDIMI 1

- Ne Dosje te Tenderit, tek **Kerkesat e Pershtatshmerise profesionale 7.1 &7.2**, Kerkesa 4 eshte kerkuar: **“ISO 56003 2019 - Menaxhimi i inovacionit për udhëheqjen e partneritetit”**.

Kjo kerkese lidhur me kete certifikate duhet te largohet sepse nuk perkon me natyren e kontrates, dhe kesisoji eshte ne kundërshtim me nenin 7 te LPP-se, sepse favorizon nje apo disa kompani te caktuara qe mund te posedojne kete certifikate.

PRETENDIMI 2

- Ne Dosje te Tenderit, tek **Kerkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2**, Kerkesa 2 eshte kerkuar: **Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë në vlerë prej së paku 300,000.00 €**.

Kjo kerkese eshte tejet diskriminuese dhe ne kundërshtim te plote me nenin 7 te LPP-se, sepse favorizon nje apo disa kompani, qe mund te posedojne kete vlere ne llogari, dhe duke patur parasysh edhe gjendjen e pandemise qe me shume se 1 vit, eshte gati e pamundur qe kjo kerkese te plotesohet nga kompanite, dhe rrjedhimisht kjo kerkese minimizon deri ne limit, konkurrencen e lire mes kompanive, prandaj edhe kjo kerkese duhet te largohet ose te ndryshohet ne: **Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë në vlerë prej së paku 300,000.00 €, ose leter mbështetese nga banka**.

PRETENDIMI 3

- Ne Dosje te Tenderit, tek **Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2**, tek Deshmia 3-8 eshte kerkuar qe per stafin menaxherial te dorezohen - **Dëshmi nga ATK-ja për pagesen e kontributeve se paku 1vit**, qe nenkupton se vetem kompania ose kompanite qe kane ne staf permanent keta inxhinier do te plotesonin kete kriter diskriminues, dhe ne baze te kesaj kerkese nuk lejohet angazhimi me kontrate mbi veper per keta inxhinier.

Edhe kjo kerkese eshte shume diskriminuese dhe favorizuese per ndonje kompani, dhe duhet te largohet teresisht nga kerkesat e Dosjes se Tenderit, sepse redukton ne maksimum konkurrencen e lire mes kompanive.

PRETENDIMI 4

- Ne Dosje te Tenderit tek **Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2**, Kerkesa 9 jane kerkuar: **1(një) Buldozer D7, 1(një) Makineri-Eskavator, minimum. Pesha 73 t, 3(tre) Makineri- Eskavator, min. Pesha 65 t, 1(një) Eskavator,min.Pesha 50 t, 1(një) Eskavator (dozer) me zingjir, min. Pesha 25 t 4(katër) Eskavator te ndryshem, 4(katër)Dumper min.Pesha 32 t, 1(një) Dumper min. Pesha 70 t, 3(tre) Dumper min.Pesha 22 t 1(një) Kamion kipper, min. Pesha 40 t, 1(një) Kamion me korpë, 3(tre) Kokë tërheqëse, 18 t, 3(tre) Gjysëmrimorkio kiper min.Pesha 32 t, 1(një) Rimorkio për bartjen e automjeteve min.Pesha 24 t, 3(tre) Kamionetë dubelkabinë, 2(dy) Ngarkues min. Pesha 35 t, 2(dy) Ngarkues min. Pesha 24 t, 2(dy) Cilindër vibrues (makine ngjeshese), 1(një) Cilindër vibrues me dhembëza, min. Pesha 21 t, 1(një) Cilindër vibrues min. Pesha 25 t, 1(një) Grejder (makine per nivelizimin e rrugeve), min. Pesha 14 t, 1(një) Çekan hidraulik, 2(dy) Auto pompë betoni, 4(kater) Kamion per transport te betonit (Autobetonierkë - mixer), 1(një) Kamion Cisternë , 1(një) Autobotë , Pajisjet e nevojshme për punët e rrugëve 1(një) Finisher për asfaltimin e rrugëve, 1(një) Makinë (Finisher) më rrota për asfaltimin e rrugëve 1(një) Cilindrat me rrota të kombinuara (gomë dhe hekur), 2(dy) Cilindrat me rrota hekuri me vibrim, 2(dy) Cilindër vibrusë min. Pesha 3t, 1(një) Makine per shtrirjen e zhavorrit per bankina te rruges 1(një) Kamion (Autobotë për pastrimin e rrugëve dhe kanalizimeve), 1(një) Spërkatës për bitumen dhe emulsion, 1(një) Makine për gërryerjen e asfaltit, 1(një) Kamion special fshisë për pastrimin e rrugeve, 1(një) Prerëse e asfaltit, 1(një) Kompresor, 7(shtatë) Kamion kiper min.Pesha 32 t,**

Numri i larte i makinerive, shumica e tyre totalisht te panevojshme dhe qe nuk perkojne fare me natyren e kontrates, specifikat e vecanta te detajizuara te ketyre makinerive, na ben te nenkuptojme qellimin e Autoritetit Kontraktues per favorizimin e nje kompanie te caktuar.

Shembull:

- 1(një) Buldozer D7**
- 1(një) Makineri-Eskavator, minimum. Pesha 73 t**
- 3(tre) Makineri- Eskavator, min. Pesha 65 t**
- 1(një) Eskavator,min.Pesha 50 t**
- 4(katër)Dumper min.Pesha 32 t**
- 1(një) Dumper min. Pesha 70 t**
- 3(tre) Dumper min.Pesha 22 t**
- 1(një) Kamion me korpë**
- 3(tre) Kokë tërheqëse, 18 t**
- 3(tre) Gjysëmrimorkio kiper min.Pesha 32 t**
- 1(një) Rimorkio për bartjen e automjeteve min.Pesha 24 t**
- 1(një) Makinë (Finisher) më rrota për asfaltimin e rrugëve**

1(një) Makine për shtrirjen e zhavorrit për bankina të rruges
1(një) Kamion (Autobotë për pastrimin e rrugëve dhe kanalizimeve)
1(një) Makinë për gërryerjen e asfaltit
1(një) Kamion special fshisë për pastrimin e rrugëve
1(një) Prerëse e asfaltit

Te gjitha keto makineri ose janë te panevojshme ose nuk kanë te bëjnë fare me natyrën e punës.

As në tenderin e ndertimit të autostradës së Gjilanit nuk janë kërkuar të gjitha keto makineri me keto specifika të detajuara, dhe poashtu aq shumë makineri te panevojshme që as në paramasën e projektit, nuk ka pozicione për shfrytëzimin e këtyre makinerive.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompanisë RSM Company, në këtë rast i shkaktohen dëme të pariparueshme sepse është e pamundur tenderimi dhe sigurimi i këtyre makinerive të specifikuara dhe kriterëve tjerë diskriminuesë.

9. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*